



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
Sektori i Burimeve Njerëzore

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL PËR KATEGORINË EKZEKUTIVE
(SPECIALIST)**

Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional ”

Sektori i Burimeve Njerëzore në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Sektori i Burimeve Njerëzore shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive:

- (1) Një Specialist i Tatim-Taksave

Sektori i Burimeve Njerëzore , Kategoria IV-3 Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje. Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 09.07.2025 DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 17.01.2025

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

-Harton rregjistrin e banesave sipas një formati të miratuar duke evidentuar llojin e biznesit, familjarin dhe të dhënat e tij, sipërfaqen e banesës, vitin e ndërtimit, nr.e pronës, lagjen, etj.

-Evidenton dhe rregjistron subjektet apo individë që kryejnë aktivitete tregtarë në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, shërbimeve apo prodhimit.

-Raporton tek sektori i të ardhurave çdo subjekt që kryen aktivitete tregtarë informal në juridiksion territorial të njësisë administrative ku operon.

-Në fund të çdo dite inspektori është i detyruar të kryejë arkëtimin në bankë ose arkën e bashkisë, sipas mandateve të arkëtimit.

-Është përgjegjës për kontrollin në territorin e zonës së caktuar, duke evindentuar, kontrolluar dhe hartuar informacion periodik me shkrim pranë përgjegjësit të sektorit.

-Ndjek dhe është përgjegjës për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara.

-Çdo muaj, merr listen e subjekteve me detyrimet e ngarkuara nga sektori i pranimit, kontakton në terren subjektet, organizon punën për arkëtimin brenda afatit ligjor.

-Ndjek rastet kur ka aktivitet ekonomik informal, informon sektorin, drejtorinë dhe drejtorinë tatimor qendrore dhe bashkëpunon për rregjistrimin e tyre.

-Evidenton dhe kontrollon dokumentacionin që disponojnë tatimpaguesit dhe nëse konstaton parregullsi zbaton procedurat tatimore duke llogaritur detyrimet dhe penaltitetet përkatëse.

-Dorëzon kontrollet e kryera, procesverbalet apo masat administrative që ka marr dhe informon periodikisht me shkrim përgjegjës të sektorit të të ardhurave.

-Dorëzon dhe Rakordon evidencën përmbledhëse të detyrimeve, të ardhurave të realizuara si dhe listën përkatëse të personave që kanë kryer pagesa me Sektorin e të Ardhurave. Është përgjegjës për kontabilizimin korrekt dhe periodik të detyrimeve tatimore.

-Përpilon dhe paraqet në fund të çdo muaji tek inspektori i mbledhjes dhe kontrollit listën

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

I.1- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria IV-3);

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);

- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Shoqërore/Juridike

- Të ketë mbi dy vit eksperiencë pune në nivel ekzekutiv;

- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

I.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sektorit të burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda dates 09.01.2025.

I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Sektori i burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista

. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 122/2020 “ Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 111/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 92/2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 68/2017 “Për financat dhe vetëqeverisjen vendore”

I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pike), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike).

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, sektori i burimeve njerëzore do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II – Për kandidatet që aplikojnë nga jashtë sistemit të shërbimit civil

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që e plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për plotësimin e vendit të lirë.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Ekonomike
- Të ketë mbi 2 vite eksperiencë pune.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë në sektorin burimeve njerëzore dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 05.08.2024, sektori i burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 122/2020 “ Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 111/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 92/2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 68/2017 “Për financat dhe vetëqeverisjen vendore”

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
2. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa:Fushë-Arrëz,Prefektura Shkoder, email: info@bashkiafushearrez.gov.al